

Intervistë e ministrit të Financave, Avdullah Hoti

## Hoti: Duhet të hyjmë në kredi për investimet kapitale

*“Jemi marrë vesh me FMN-në që të hyjmë në kredi ndërkombëtare derisa borxhi publik arrin deri në 30 për qind në mënyrë që mos të arrihet maksimumi i paraparë në ligj dhe të kemi një hapësirë për qeveritë e ardhshme që të kenë mundësi të hyjnë në borxhe publike. Kjo rregull e ndryshuar fiskale neve na lejon të financojmë projektet kapitale”, ka thënë ministri i Financave, Avdullah Hoti*

Visar Prebreza

Prishtinë, 19 korrik - Nënshkrimi i kontratave milionëshe nga ish-Qeveria Thaçi ia ka pamundësuar Qeverisë aktuale të iniciojë projekte të reja kapitale. Ministri i Financave, Avdullah Hoti, thotë se hyrja në borxh ishte mundësia e vetme për t'i shtyrë përpara projektet që sjellin më shumë zhvillim dhe krijojnë vende të reja të punës. Me borxhe do të financohen projekte në infrastrukturën rrugore, atë hekurudhore, por edhe në bujqësi, shëndetësi e arsim.

Në intervistën dhënë “Kohës Ditore”, ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka folur edhe për shpenzimet joracionale të Qeverisë së kaluar, buxhetin joreal të vitit 2015, për efektet e pakos fiskale në zhvillim ekonomik, rritjen e produktiviteti dhe vetë rritjen ekonomike.

KD: Këtë vit në rishikimin buxhetor kemi pasur një ndryshim të theksuar të buxhetit fillestar, flas për të hyrat dhe shpenzimet. A ka qenë kërkesë e Fondit Monetar Ndërkombëtar të bëhen ndryshime të tilla?

A.Hoti: Kur e kemi aprovuar buxhetin më 29 dhjetor të vitit 2014 ka qenë buxhet që ne e kemi trashëguar prej Qeverisë paraprake dhe për shkak të kohës shumë të shkurtër nuk kemi pasur mundësi që të hyjmë e të bëjmë ndryshime të mëdha në buxhet. Atëherë jemi pajtuar që ky buxhet ka të hyra që janë të mbivlerësuara, dhe janë të mbivlerësuara bukur shumë. Janë rreth 120 milionë euro të hyra për ATK-në dhe Doganës që kanë qenë mbi parashikimet. Ka pasur parashikime që të hyrat e këtyre organizatave mund të rriten deri në 40 për qind, që nuk është e realizueshme në terma praktikë. Atëherë kemi dhënë zotime se kur të vijë mesi i vitit, ne do të përcjellim performancën e të

hyrave të ATK-së dhe Doganës në gjashtë muajt e parë dhe mbi atë bazë do të nxjerrim objektivat që këto organizata mund të realizojnë deri në fund të vitit. Rishikimi ka marrë këtë parasysh. Të dyja këto organizata kanë një plan të të hyrave që është në terma realë.

KD: Çfarë është shkurtuar tek shpenzimet që janë ulur për 49 milionë?

A. Hoti: Të gjitha projektet kapitale që kanë qenë në buxhetin fillestar vazhdojnë deri në fund, ashtu siç vazhdojnë edhe pagat. Nuk preket në esencë asnjë shpenzim. Zvogëlimi i shpenzimeve prej 49 milionë eurove janë vetëm kursime. Kursime në paga, kursime në mallra dhe shërbimeve. Të hyrat janë zvogëluar prej 52 milionë eurove dhe janë kompensuar me të hyrat shtesë prej reformës ligjore dhe ligji për faljen e borxheve prodhon efekt buxhetor, sepse ne do t'i mbledhim borxhet e vjetra. Kemi rritur akcizat në prill, ju e dini ka qenë një vendim për rritje të akcizave në duhan dhe alkool, që kanë prodhuar efekt buxhetor. Pra, e kemi kompensuar atë 120-milionëshin fillestar të zvogëlimit të parashikimit të të hyrave.

KD: Në buxhet thuhet se 24 milionë euro janë kursyer në paga. Ndërkohë që pagat nuk janë ulur e as numri i punëtorëve nuk është zvogëluar. A mund të përkthehet kjo sikur këto para në të kaluarën janë marrë në emër të pagave në mënyrë të pamerituar?

A.Hoti: Jo, nuk mund të përkthehet ashtu, por i kemi racionalizuar udhëtimet jashtë vendit. Këtë vit ka shumë më pak udhëtime jashtë vendit. Edhe aty nënkupton se ka shumë më pak shpenzime për bileta, për akomodim, për mëditje jashtë. Ka shumë më pak shpenzime për transport. Në janar unë e kam marrë një vendim kur ne e kemi ndaluar pagesën shtesë nëpër komisione. Nuk nënkupton që ato janë keqpërdorur, veç që tash po i shpenzojmë në mënyrë pak më racionale.

KD: Pra, ka pasur shpenzime joracionale?

A.Hoti: Unë më shumë tentoj me fol për të tashmë. Shfrytëzim më i mirë po e quajmë, shpenzim më i mirë i parasë publike. Gjithashtu edhe sigurimi shëndetësor është shtyrë për një kohë, e edhe aty kemi pasur një shumë të mjeteve që ishin të destinuara për sigurimin shëndetësor. Të gjitha këto masa kanë treguar se ne mund të kursejmë 49 milionë euro pa e prekur në esencë të shërbimeve që ofrohen për bizneset dhe qytetarët, pa rrezikuar pagën në sektorin publik, bile pagat janë rritur, sepse kemi filluar pagesën e përvojës së punës.

## **Funksionalizimi i hekurudhave**

KD: Një nga pikat kryesore të marrëveshjes së arritur me FMN-në keni thënë se është mundësia për të hyrë në borxhe. Për buxhetin e vitit 2016 është paraparë që të ketë edhe borxhe për financimin e projekteve kapitale?

A. Hoti: Trendët do t'i shohim bazuar edhe se si do të përmbyllim vitin, por rishikimi i buxhetit e vendos buxhetin shtetëror në terma realë. Mbi këtë bazë e kemi një parashikim për vitin 2016. I kemi projektet që do të hyjnë në 2016. Janë investimet kapitale që mund të planifikohen, sepse pagat, pensionet e subvencionet veç vazhdojnë me trendin e tyre të natyrshëm. Ndërsa, për projekte kapitale kemi pak hapësirë për të futur projekte të reja. Prandaj, kemi punuar shumë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, kemi arritur një program dhe jemi pajtuar që të ndryshojmë rregullën fiskale. Rregulla fiskale për momentin thotë që Qeveria nuk mund të shpenzojë brenda vitit më shumë se 2% të GDP-së se sa që i ka të hyrat, pra nuk mund të hyjnë në borxhe publike për të financuar projektet publike më shumë se 2 për qind të GDP-së. Jemi pajtuar që të ndryshojë kjo rregull fiskale. Kjo rregull fiskale do të vlejë për buxhetin e rregullt, ndërkaq kur arrijmë të hyjmë në kredi ndërkombëtare të mos vlejë kjo rregull fiskale, pra na lejohet të hyjmë në kredi ndërkombëtare për të financuar projekte zhvillimore. Duke u nisur prej faktit që borxhi aktual publik që kemi është rreth 10 për qind e GDP-së, krahasuar me vendet e rajonit që kanë 70, 80 apo 100 për qind të GDP-së. Pra, kemi mjaft hapësirë për të rritur buxhetin publik.

KD: Sa është kufiri maksimal i borxhit publik që ju lejohet me marrëveshjen që keni bërë me FMN-në?

A. Hoti: Kufiri maksimal i borxhit publik, sipas Ligjit për borxhin publik është 40 për qind e GDP-së, kurse ne tani jemi në 10 për qind të GDP-së. Jemi marrë vesh me FMN-në që të hyjmë në kredi ndërkombëtare derisa borxhi publik arrin deri në 30 për qind në mënyrë që mos të arrihet maksimumi i paraparë në ligj dhe të kemi një hapësirë për qeveritë e ardhshme që të kenë mundësi të hyjnë në borxhe publike. Kjo rregull e ndryshuar fiskale neve na lejon të financojmë projektet kapitale.

KD: Më herët thatë që ka pak hapësirë për projekte të reja të financuara nga buxheti. Pra, borxhi ka qenë mundësia e vetme për të shtyrë përpara projektet e reja, pasi Qeveria e kaluar ka hyrë në kontrata milionëshe në fund të mandatit?

A. Hoti: Buxheti për investimet kapitale është 95 për qind i kontraktuar edhe për dy vitet e ardhshme. Ne, tek në fund të vitit 2017 dhe në fillim të vitit 2018 e kryejmë autostradën, e cila e konsumon pjesën më të madhe të investimeve kapitale. Ka plot

rrugë e shkolla në shumicën e vendit që janë të kontraktuara dhe që vazhdojnë edhe në 2-3 vitet e ardhshme. Pra, ka pak hapësirë për të futur projekte të reja, prandaj kemi gjetur një rrugë tjetër që është mjaft inovative për të futur projekte kapitale me financim publik, përmes kredive koncesionare. Në fund të fundit, të gjitha shtetet kështu janë zhvilluar dhe kështu ndërtohet infrastruktura e cila është një e mirë që vlen edhe për gjeneratat e ardhshme. Meqë është kështu ka logjikë ekonomike që edhe gjeneratat e ardhshme të paguajnë pjesë të kostos së kësaj infrastrukture që e shfrytëzojnë në të ardhmen dhe borxhi publik e ka këtë logjikë. Hyrja në borxhe për 20 vitet e ardhshme për të ndërtuar hekurudhat apo sistemin e ujitjes në bujqësi do të thotë se nga taksat që merren viteve të ardhshme paguhen kostot e këtij projekti.

KD: Cilat janë kriteret që duhet t'i plotësojë një projekt që ai të financohet përmes borxhit?

A.Hoti: Ne jemi pajtuar me Fondin Monetar që të nxjerrim një listë të projekteve prioritare, të cilat kanë efekte më të mëdha zhvillimore me krijimin e punësimit, me rritjen e të ardhurave, me zvogëlimin e varfërisë. Këto janë projekte që do të pajtohet edhe FMN-ja që t'i financojmë me kredi publike përtej rregullës fiskale. Një listë prioritare veç e kemi dhe në disa prej tyre kemi avancuar bukur shumë.

KD: Cilat janë ato projekte?

A.Hoti: Është projekti i hekurudhave, që parasheh funksionalizim të plotë të rrjetit hekurudhor që kemi në Kosovë edhe për qarkullim të mallrave dhe qëllimeve tjera. Jemi duke finalizuar marrëveshjen dhe shpejt besoj që e nënshkruajmë, për rikonstruktimin e hekurudhës nga Hani i Elezit deri në Leshak, në kufi me Serbinë. Rikonstruktimi i hekurudhës nga Fushë-Kosova në Podujevë dhe linjës nga Klina në Prizren, sepse linjat tjera janë funksionale dhe kështu do të funksionalizohen të gjitha linjat e hekurudhave. Janë kryer studimet e fizibilitetit për disa rrugë regjionale, siç është ajo që vazhdon nga Mitrovica në Skenderaj e që vazhdojnë në Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Dhe rruga tjetër nga Gjilani në Ferizaj e që vazhdon për në Dheun e Bardhë. Dy prej këtyre segmenteve ne kemi vendosur t'i çojmë përpara me financim nga BERZH-it. Është segmenti nga Mitrovica në Prizren dhe Ferizaj për në Dheun e Bardhë.

KD: Pra, janë këto projekte që mund të realizohen në një kohë më të shkurtër?

A.Hoti: Po për hekurudha e nënshkruajmë marrëveshjen brenda dy muajve, kurse brenda këtij viti duhet të përgatiten të gjitha projektet detaje që nënshkruajmë marrëveshjen edhe për këto me BERZH-in, pasi negociatat janë finalizuar, janë

dakorduar kushtet e kredisë dhe pritet vetëm aprovimi nga bordi i BERZH-it dhe nënshkrimi i marrëveshjes.

KD: Këto janë në infrastrukturë. Ka projekte të tjera?

A.Hoti: Përmes këtyre projekteve ne po e kompletojmë rrjetin e rrugëve dhe hekurudhave. Kurse, janë dy projekte të tjera në bujqësi për ujitjen e tokave bujqësore. Njëri është Ibër-Lepenci, përkatësisht zgjerimi i mbulueshmërisë së tokave bujqësore. Ky është projekt që e ka lënë Banka Botërore.

KD: Është pjesë e dytë e projektit, ajo e Lepencit?

A.Hoti: Po, projekti parasheh që të shkojë deri në Ferizaj. Është projekt i Bankës Botërore që është lënë në gjysmë në atë kohë dhe tash kanë shprehur interes që të mbështesin atë. Është projekti i zgjerimit të sistemit të Radoniqit që shtrihet deri poshtë në Prizren dhe kodrave në dy anët e Drinit të Bardhë. Me këto dy projekte dyfishohen tokat që janë në ujitje dhe kjo nënkupton që mund të dyfishohet produkti bujqësor. Është një projekt tjetër i madh që është duke punuar Ministria e Arsimit për informatizim të plotë të shkollave me kabinete të IT-së dhe projekte tjera. Dhe është një projekt tjetër i Spitalit në Prishtinë, i Ministrisë së Shëndetësisë. Këto janë projekte që i kemi të njohura e që do të kërkojmë financim ndërkombëtar. Në disa kemi avancuar bukur shumë, siç janë ato të infrastrukturës. Me këto të bujqësisë kemi disa studime të parafizibilitetit dhe duhet të bëhen studime të plota të fizibilitetit dhe projektet detaje. Po punohet edhe në projekte tjera. Edhe ministri i Mjedisit është duke e bërë një pako me projekte më të vogla për trajtimin e ujërave të zeza nëpër komuna dhe rregullimin e shtratit të lumenjve. Të gjitha këto janë projekte që mund ta rrisin borxhin publik deri në 400 - 450 milionë euro shtesë, por që krijojnë efekte në ekonomi.

KD: Bazuar në studimet e Bankës Botërore vetëm projekti i Lepencit që e përmendët kushton rreth 300 milionë euro.

A.Hoti: Nuk i di detajet, sepse nuk i kemi kostot për të gjitha këto projekte. Deri më tani e kemi vetëm koston e hekurudhave.

## Reforma fiskale

KD: Në fillim të këtij viti janë ndryshuar tri ligjet bazike fiskale, që është quajtur si reforma fiskale. Cilat janë pikat kryesore të kësaj reforme, nëse mund të tregosh qëllimin final të këtyre ndryshimeve?

A.Hoti: Reforma fiskale që kemi ndërmarrë gjatë këtij gjashtëmujori është më e madhja që ka ndodhur deri më tani prej fillimit që kur janë aplikuar këto ligje. Janë dy qëllime të kësaj reforme: qëllimi zhvillimor që të promovojë zhvillimin ekonomik, punësimin dhe tjetra është aspekti social. Nëse i analizojmë këto tri ligje i prekin këto dy segmente. Heqja e TVSH-së në import të makinerive dhe një listë të lëndës së parë që nuk prodhohen në vend, presim që do të prodhojë efekte zhvillimore. Kurse, heqja e TVSH-së nënkupton se çdo investim është për 16 për qind më i lirë sesa që ka qenë deri më tash. Kemi hequr edhe TVSH-në për pajisjet e IT-së, pra edhe ato do të jenë për 16 për qind më të lira, duke qenë se është një sektor që ka zhvillim të hovshëm në vitet e fundit. Janë plot ndryshime tjera tek njohja e borxheve të këqija, pasi u njihen ato për zbritje nga të ardhurat e tatueshme. Njohja e shpenzimeve për trajnimin e punëtorëve, për shujta dhe për shpenzime tjera që bëhen për punëtorët. Tek aspekti social kemi vendosur që të ulim TVSH-në nga 16 në 8 për qind për mallrat elementare, të cilat përbëjnë 70 për qind të kostos së një familjeje mesatare. Ky është aspekti social, pasi do të përgjysmohet shkalla tatimore për familjet mesatare.

KD: Ishte paralajmëruar që të hyjnë në fuqi në korrik e tash po flitet për shtator?

A.Hoti: Ne po planifikojmë më 1 shtator të hyjnë në fuqi, sepse duhet të bëhen disa përgatitje nga ATK-ja, Dogana dhe udhëzime administrative që duhet të aprovohen për të funksionalizuar këto ligje.

KD: Komisioni parlamentar ka kërkuar që tatimi në dividend i propozuar të hiqet. A do të këmbëngulni që Kuvendi të votojë propozimin tuaj, apo pajtoheni me kërkesën e Komisionit parlamentar?

A.Hoti: Ne kemi pasur argumentet tona që të fillojmë të vendosim këtë dividend, anëtarët e Komisionit për buxhet dhe financa kanë menduar ndryshe. Ne nuk do të insistojmë në këtë çështje. Ndoshta ka nevojë që për një kohë të mos aplikojmë këtë tatim në dividend për të nxitur investimet e jashtme.

KD: Ligji i ri i TVSH-së e ka dhe një nen që lihet në diskrecion të ministrit që të zgjerojë listën e produkteve që i përgjysmohet apo hiqet krejt TVSH-ja. Sa mund të keqpërdoret ky nen, duke marrë parasysh vendimet populiste që janë marrë nga qeveritë e kaluara në prag të zgjedhjeve?

A.Hoti: Jemi në vitin 2015 dhe ne duhet të promovojmë zhvillimin e sektorit të bujqësisë, pasi importojmë rreth 600 milionë euro. Pastaj është zhvillimi i sektorit të IT-së, sepse ka shumë të rinj që janë duke punuar në këtë sektor. Kjo listë e mallrave që lirohen nga TVSH-ja kryesisht janë të këta dy sektorë. Pajisjet e IT-së lirohen nga TVSH-ja. Produkteve bujqësore u përgjysmohet TVSH-ja. Pas 5 viteve, sektori i IT-së mund të mos jetë më prioritet dhe mund të hiqet lista e produkteve të IT-së e të vendoset diçka tjetër. Pas 5 viteve një listë e caktuar e produkteve bujqësore nuk ka nevojë më të trajtohet në mënyrë të veçantë. Pra, mund të ndërrojnë prioritetet pas disa viteve dhe ky ligj lejon këtë fleksibilitet që në bazë të ndryshimeve dhe zhvillimeve ta zgjerojmë apo ngushtojmë atë listë. Megjithëse ky diskrecion i ministrit është i kufizuar në listën e mallrave që janë të parapara në ligj, pra është një listë në ankesë të ligjit që është në pritje. Krejt diskrecioni i ministrit është që të marrë produkte nga lista rezervë e të futë në nenin e ligjit dhe të nxjerrë nga neni e të çojë atje.

KD: Cili është rreziku që me një vendimi populist Qeveria para zgjedhjeve të ulë çmimin e rrymës për 8 për qind, pra të ulë TVSH-në në zero?

A.Hoti: Mendoj që e kemi krijuar një mentalitet institucional që nuk mund të merren vendime që mund të rrezikojnë stabilitetin fiskal të vendit. Së paku kjo Qeveri ka dhënë dëshmi që nuk e bën atë. Prej momentit që kemi filluar, plot vendime që kemi marrë nuk kanë qenë populiste dhe jemi kritikuar për atë, por janë vendime në të mirë të stabilitetit ekonomik dhe fiskal të vendit. Kemi pasur bukur shumë konfrontime me sindikatat për t'i bindur ata që nuk ka hapësirë për një rritje tjetër të pagave. Dhe plot vendime tjera që nuk janë populliste, por institucionale.

KD: Jeni pjesë e Komitetit Drejtues të projektit "Kosova e Re". Ku ka arritur ky projekt?

A.Hoti: Ministri i Zhvillimit Ekonomik është më kompetent për të folur për këtë temë, por mund t'ju them se diskutimet për projektin "Kosova C" janë gati në finalizim. Janë edhe tri-katër çështje që këshilltarët që janë të angazhuar në projekt janë duke negociuar me kompaninë "Contour Global" dhe besoj që për një apo dy muaj mund të vijmë në përfundim se a do të shkojmë përpara me këtë kompani apo jo. Ato që unë po mundohem me u kujdes si ministër i Financave në Komitetin Drejtues të këtij projekti është të sigurojmë që po hyjmë në një transaksion që në të ardhmen nuk do të krijoj barrë të papërbalueshme për buxhetin e shtetit. Sepse ne si Qeveri duhet të lëshojmë

disa garanci për investimet që bëhen aty, e garancitë praktikisht janë borxh publik. Ne do të sigurohemi që nuk po bëjmë ndonjë lëshim që në të ardhmen do të ketë kosto buxhetore. Edhe e dyta, të hyjmë në një transaksion që pas fillimit të furnizimit me energji elektrike ajo energji të jetë me çmime të përballueshme për qytetarët. Këto janë dy kritere që po kujdesimi që t'i arrijmë gjatë negociatave.

KD: Sa është e vështirë të parandalohet rritja e madhe e çmimit të energjisë, duke marrë parasysh koston e lartë të ndërtimit, por edhe kosto të fshehta të këtij projekti?

A.Hoti: Këtu është edhe esenca, sepse ne po kërkojmë që të gjitha kostot të jenë eksplicite, të njohura dhe të ditura paraprakisht. Pra, ne duhet të dimë se në çfarë projekti po hyjmë, çfarë shkalle të rrezikut po marrim përsipër dhe mos të marrim rreziqe që mund të mos jenë të përballueshme në të ardhmen.

KD: Një tjetër pikë në energjetikë që ka bërë bujë vetëm pasi ishte pjesë e deklaratës së kancelares Merkel, është ideja për rindërtimin e "Kosovës A". Çfarë do të ndodhë tash me këtë projekt, a keni bërë ndonjë kërkesë ndaj saj?

A.Hoti: Ne kemi pasur dy takime me kompaninë "Bilfinger" këtu në Prishtinë. Ata e kanë prezantuar projektin e tyre për rikonstruktim të blloqeve të termocentralit "Kosova A", por nuk kanë ofruar model financiar, pra se si do të financohet. I kemi takuar edhe në Gjermani dhe e kemi bërë të njëjtën kërkesë. Në parim, projekti është interesant, sepse e mbulon atë zbrazëtirën e furnizimit me energji elektrike pas vitit 2017, kur mbyllet blloqet e TC "Kosova A" dhe deri në kohën kur të nisë prodhimi në termocentralin e ri. Përmes këtij projekti mund të mbyllet kjo hapësirë, por edhe nuk kemi një propozim konkret sa i përket financimit të këtij projekti.

KD: Do të thotë që "topi" është tek kompania, që ata duhet t'ju bindin juve me propozim financiar?

A.Hoti: Kërkesa ndaj kompanisë ka qenë kjo, na ofroni një propozim për financimin e këtij projekti.



## Statistikat joreale

KD: Agjencia e Statistikave thotë se rritja ekonomike në vitin 2014 ka qenë vetëm 0.9 për qind?

A.Hoti: Tani nuk po dua të hyj nëse rritja ekonomike ka qenë 0.9 për qind, apo 3 për qind. Atë që unë pajtohem është që cilësia e të dhënave në Kosovë është shumë e ulët, sidomos cilësia e të dhënave në bazë të të cilave ne mund të nxjerrim rritjen ekonomike. Është për keqardhje që ne pas shumë viteve për ngritje të kapacitete të Agjencisë së Statistikave ende nuk mund t'u besojmë plotësisht të dhënave të tyre. Dhe atëherë kur mund t'u besojmë, ato të dhëna janë aq të vonshme saqë janë të papërdorshme. I prodhojnë të dhënat në baza kuartale, por i prodhojnë me shumë vonesë saqë nuk mund të bazohemi në planifikimet e rregullta buxhetore. Në Ministri të Financave i përdorim edhe të dhënat që i nxjerrim nga departamenti i politikave ekonomike. Në programin e FMN-së e kemi edhe një pikë për ngritjen e kapacitetit të ASK-së për të prodhuar të dhëna të përdorshme dhe të besueshme. Këto ditë kalon koncept-dokumenti për statistika shtetërore, e pastaj do të kemi edhe ligjin i cili do t'i vendosë disa rregulla për prodhimin e statistikave zyrtare në përputhje me kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare. Ajo që është vitale është rritja e kapacitetit dhe e cilësisë së punës që bëhet nga ASK-ja.

KD: Njëra nga të dhënat e fundit të ASK-së ka qenë edhe rritja e papunësisë në nivel prej 18 për qind në vitin 2014, nga 30 në 35 për qind.

A.Hoti: Prandaj po them që kohë pas kohe Agjencia e Statistikave po na befason. Me vlerësime që janë surprizë dhe jashtë kontekstit nganjëherë.

KD: Sa do të jetë rritja ekonomike për vitin 2015?

A.Hoti: Vlerësimet tona janë që do të jetë rreth 3 për qind. Nëse do t'i ndiejmë shpejt efektet e kësaj pakoje fiskale mendoj që do të shkojë përtej kësaj. Nëse projekti i Brezovicës, që është investim shumë i madh, do të fillojë të implementohet brenda këtij viti do të mund të prodhojë disa efekte. Përfundimisht vitin e ardhshëm pres që do të kemi kapërcim të madh të rritjes ekonomike me këto projekte zhvillimore që i përmenda më herët.